1.1.2.5	Taksat tjera komunale	10,000	10,000	15,000	15,000
1.1.4	Ngarkesat komunale	206,228	203,812	205,813	206,613
1.1.3.1	Ngarkesat regullatore	28,000	28,000	30,000	30,000
1.1.3.2	Të hyrat nga qiraja	30,000	30,000	30,000	30,000
1.1.3.3	Bashkë-pagesat për arsim	30,613	30,612	30,613	30,613
1.1.3.4	Bashkë-pagesat për shëndetësi	26,000	26,000	26,000	26,000
1.1.3.5	Ngarkesat tjera komunale (gjobat)	91,615	89,200	89,200	90,000
1.1.5	Të hyrat tjera	35,187	36,767	36,767	55,139
1.2	TRANSFERET QEVERITARE	6,838,559	7,495,209	7,838,373	8,123,370
1.2.1	Granti i Përgjithshëm	3,061,138	3,184,460	3,461,878	3,678,540
1.2.2	Granti specifik për Shëndetësi	910,169	1,002,270	1,052,384	1,105,003
1.2.3	Granti specifik për Arsime	2,867,252	3,308,479	3,324,111	3,339,827
1.3.	Huamarrja	29,745.00	100,012	-	-



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01 - Nr. 400/01-31236/18
Kaçanik; 27.09.2018

Mbështetur në nenin 40.2 (b.) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008), të Ligjit Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të Ligjit nr.03/L-221, – Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nenit 15 dhe 16 të Ligjit nr.(Nr.06/L-020) - Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, të nenit 34.5 lidhur me nenin 17 dhe 61 të Statutit të Komunës të datës 25.09.2008, duke vepruar sipas Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr. 400/01-31236/18 të datës 19.09.2018, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 27 Shtator 2018, mori këtë:

V E N D I M
PËR RIALOKIMIN DHE TRANSFERIN E MJETEVE BUXHETORE SIPAS BUXHETIT
TË VITIT 2018

1. Transfer i mjeteve nga kategoria e shpenzimeve, Mallra dhe Shërbime në kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve (10):

2.1. Në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtja Civile dhe Emergjencia (180) Infrastruktura rrugore (18028) kodi funksional (0451), shuma: 12,000.00 € → **Transferohen:** Në kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve në Arsim dhe Shkencë (920) Nën-programin Administrata e Arsimit (92140) me kod funksional (0980) në shumë: 12,000.00.

2. Transfer i mjeteve nga kategoria e shpenzimeve, Mallra dhe Shërbime në kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve (21):

2.1. Në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtja Civile dhe Emergjencia (180) Infrastruktura rrugore (18028) kodi funksional (0451) në shumë: 8,000.00 € → **Transferohen:** Në kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve në Arsim dhe Shkencë (920) Nën-programin Administrata e Arsimit (92140) me kod funksional (0980) në shumë: 8,000.00

3. Ri-alokim i mjeteve në kuadër të kategorisë së Shpenzimeve Kapitale, burimi i financimit (22):

3.1 Në kuadër të Drejtorisë Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile dhe Emergjencia (180) Infrastruktura rrugore (18028) kodi funksional (0451) nga projekti kapital “Rregullimi i trotuarit në lagjen Imisht” me kod 46548, shuma: 5,000.00 € → **Rialokohet:** Në projektin kapital “Ndërtimi i Urës për këmbësorë mbi Lumin Lepenc” me kod 43992 në shumë: 5,000.00 €.

4. Ri-alokim i mjeteve në kuadër të kategorisë së Shpenzimeve Kapitale, burimi i financimit (22):

4.1 Në kuadër të Drejtorisë Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale (730) Shërbimet e Shëndetësisë Primare (74700) me kod funksional (0721) nga projekti: “Renovimi i objekteve dhe infrastrukturës shëndetësore”, me kod (46820) në shumë: 10,000.00 €, → **Rialokohet:** Në projektin “Veturë për ndihmë të shpejtë”, me kod (46822) në shumë prej 10,000.00 €.

5. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë Formularët standard nga MF. të plotësuar me shumat e lëvizura sipas nën-programeve buxhetore dhe kodeve ekonomike të shpenzimeve.

6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të autoritetit mbikëqyrës - MAPL, si dhe 7 Ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës

7. Për realizimin e këtij Vendimi obligohet, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, e cila drejtori të njëjtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim (nëpërmjet kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante); dhe
3. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01Nr. 104/02-30935/18

Kaçanik, 27.09.2018

Bazuar në nenin 58 pika h. e Ligjit Nr.03/L040 Për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/04 Qershor 2008), të nenit 5.7. paragrafi 1 i Ligjit nr.04/L-144- Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.35/17 dhjetor 2012), të nenit 5 të Rregullores QRK 23/2013- Për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, të nenit 3 të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01 Nr.104/02-30935/18 Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 27 Shtator 2018, mori këtë:

**VENDIM PARAPRAK
PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË
SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR**

1. Me këtë Vendim, merret Vendim Paraprak për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës së Kaçanikut në Zonën Kadastrale Kaçanik, ngastra kadastrale nr.5-0 në sipërfaqe prej 3885m² apo shprehur në ha. 00.38.85, e cila gjendet brenda sipërfaqës së përgjithshme prej 1.26.38 ha të ngastrës kadastrale Nr.5-0.
2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur si në pikën 1 të këtij Vendimi do të jepet në **SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR**, për ushtrimin e veprimtarisë së tregut të kafshëve në afat për **Pesëmbëdhjetë (15) vite**.
3. Procedura për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim për periudhë afat shkurtë do të bëhet përmes konkurrencës (Ankandit Publik) dhe procedurave të parapara me Ligjin Nr.04/L-144, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e shërbimeve publike, Drejtoria për Ekonomi, Financa e Zhvillim.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të autoritetit mbikëqyrës - MAPL, si dhe 7 Ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.
6. Me marrjen e këtij Vendimi Shfuqizohet Vendimi Paraprak i Kuvendit të Komunës 01Nr. 08-16-34875/16 i datës 28 Tetor 2016, për dhënie e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër, ngastrën kadastrale Nr. 5-0, në sipërfaqe 1.26.38 ha.

Arsyetim

Kryetari i Komunës Kaçanik i është drejtuar me Propozim Vendim 01 Nr.104/02-30935/18 Kuvendit të Komunës nga data 14.09.2018 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së tërësishme prej 00,38,85 ha.

Me datë 28.10.2016 Kuvendi i Komunës për parcelën në fjalë kishte marrë Vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës për sipërfaqen e tërësishme prej 1,26,38 ha. Mirëpo, sipas arsyetimeve të Kryetarit të Komunës, kompania përfituese nga Ankandi Publik, në afatin prej tre muajsh ka hequr dorë nga shfrytëzimi dhe ka bërë Kërkesë për shkëputje të Kontratës me arsyetimin se sipërfaqja prej 1,26,38 ha është e pa shfrytëzueshme, për shkak të formës së parcelës dhe arsyeve tjera siç janë: Kalimi i kanalit të ujitjes për ujitje, për zonën kadastrale Kaçanik si dhe përfshirja e rrugës publike për fshatin Kovaçec dhe kështu Kryetari i Komunës kishte aprovuar kërkesën e kompanisë për shkëputje të kontratës.

Duke u bazuar në arsyetimet e Kryetarit të Komunës të potencuar me lartë dhe arsyetimeve të tjera së; janë bërë investimet për rregullimin e tregut të kafshëve, arsyeshmërinë për dhënien në shfrytëzim të parcelës- pjesën prej 00, 38.85 ha të kësaj prone Komunale dhe se më dhënien e kësaj prone komunale në shfrytëzim sipas dispozitave ligjore në fuqi, komuna do të mund të inkasoj të hyra komunale të cilat konsiderohen para publike dhe i nënshtrohen dispozitave ligjore për menaxhimin e financave publike. Gjithashtu Kryetari i Komunës në arsyetimin e tij ka theksuar se fermerëve do t'iu krijohen kushte më të mira për plasimin në treg të kafshëve të gjalla, respektimin e masave për mbrojtjen e shëndetit publik dhe shëndetit të kafshëve, përfshirë mirëqenien e tyre si dhe mundësinë e krijimit të vendeve të reja të punës. Nga ajo që u theksua me lartë, arsyetimeve të Kryetarit të Komunës të theksuara, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 27 Shtator, shqyrtoj Propozim Vendimin e Kryetarit të Komunës 01Nr. 104/02-30935/18 dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.





Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik

Opština Kaçanik

Municipality of Kaçanik

01.Nr. 104/02-31499/18

Kaçanik, 27 .09.2018

Mbështetur në nenin 6 pika 1.1 lidhur me nenin 17.8 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor 04/L-174; të Kapitulli V.1 të Planit Zhvillimor Komunal, të nenit 14 lidhur me nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008) të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01 Nr. 104/02-31499/18 prej datës 21.09.2018, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 27 Shtator 2018, mori këtë:

VENDIM

**PËR NDRYSHIMIN E DESTINIMIT SIPAS PZHK-së PËR PARCELËN KADASTRALE 516-1,
ZONA KADASTRALE KAÇANIK**

1. Me këtë Vendim, MIRATOHET Propozim Vendimi i Kryetarit të Komunës për ndërrimin e destinimit të parcelës kadastrale nr.516-1, Zona Kadastrale, Kaçanik sipas PZHK-së, nga **“gjelbërim”** në **“ afarizëm-industriale”**.
2. Sipas pikës 1. të këtij vendimi, toka me destinim “gjelbërim”, parcela kadastrale nr.516-1, e evidentuar në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme P-70917048-00516-1, Zona Kadastrale Kaçanik, në pronësi të Mevlude Dushkaja, Destinohet Zonë për Afarizëm dhe Industriale.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë: Kopja e Planit, Fleta Poseduese dhe Akti Noterial i Deklaratës nën Betim të pronares së Pronës, Mevlude Dushkaja , ku deklarohet se nëse Komuna ka interes që kjo pronë të rikthehet në aktivitetin e gjelbërimit, nuk do të bëjë pengesë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen : Kryetari i Komunës, Drejtoria Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

Arsyetim

Kryetari i Komunës Kaçanik me datë 21 Shtator 2018, i është drejtuar Kuvendit të Komunës Kaçanik me Propozim Vendim 01Nr.104/02-31499/18 - Për ndërrimin e destinimit të parcelës së përcaktuar si në pikën 1 të këtij vendimi, sipas PZHK-së, prej zonë “gjelbërim” në “zonë afariste-industriale”.

Kuvendi i Komunës Kaçanik, me datë 27 Shtator 2018, shqyrtoj Propozim Vendimin e Kryetarit të Komunës me Numër të sipërcituar dhe duke u nisur nga arsyetimet e drejtorisë për Urbanizëm, Kadastrë dhe Mbrojtje të Mjedisit të theksuara si në Propozim Vendim se: Plani Zhvillimor Komuna në kapitullin V.1. e lejon një ndryshim të tillë (ku shkruan: Rishikimi i planit bëhet çdo pesë vite, por **rishikimi dhe ndryshimet eventuale mund të bëhen edhe në periudha tjera kohore, varësisht nga vendime politike apo kërkesat e caktuara të komunitetit lokal**): Arsyetimet tjera të DUKMM se aktiviteti i komunës në këtë pjesë ka qenë zero, duke mos lëvizur në drejtimin e zbatimit të PZHK-së për implementimin e “gjelbërimit” në këtë zonë. Po ashtu investimi që pretendohet të bëhet pas ndryshimit të destinimit të kësaj parcele do të jetë i madh dhe me ndikim në ekonominë e komunës, propozohet ky vendim si dhe deklaratën e Mevlude Dushkaja, ku thekson se nëse komuna ka interes të realizojë destinimin e PZHK-së për ngastrën e tij kadastrale, ajo nuk do të jetë pengesë, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 27 Shtator 2018, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kryesuesi i Kuvendit

Kemal Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01.Nr. 104/2-31499/18

21.09.2018

Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Kaçanikut duke u bazuar në Ligjin për Planifikimin Hapësinor 04/L-174; në bazë të Planit Zhvillimor Komunal, respektivisht kapitulli V.1. duke u bazuar në statutin e komunës së Kaçanikut; pas kërkesës së pronarit, DUKMM dhe Kryetari i Komunës bën këtë:

PROPOZIM VENDIM PËR NDRYSHIMIN E DESTINIMIT SIPAS PZHK-së PËR PARCELËN KADASTRALE 516-1, ZONA KADASTRALE KAÇANIK

I

Me këtë propozim vendim MIRATOHET kërkesa për ndërrimin e destinimit të parcelës kadastrale nr.516-1, z.k. Kaçanik sipas PZHK-së, nga **“gjelbërim”** në **“afarizëm-industriale”**.

II

Sipas pikës I të këtij vendimi, toka me destinim “gjelbërim”, parcela kadastrale nr.516-1, e evidentuar në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme P-70917048-00516-1, zona kadastrale Kaçanik, në pronësi të Mevlude Dushkaja, destinohet zonë për afarizëm dhe industriale.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Kryetari, Besim Ilazi

Arsyetim

Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka pranuar kërkesën nga pronari i tokës për ndërrimin e destinimit, sipas PZHK-së, prej zonë “gjelbërim” në “zonë afariste-industriale”.

Pasi që Plani Zhvillimor Komunal në kapitullin V.1. e lejon një ndryshim të tillë (ku shkruan: Rishikimi i planit bëhet çdo pesë vite, por **rishikimi dhe ndryshimet eventuale mund të bëhen edhe në periudha tjera kohore, varësisht nga vendimet politike apo kërkesat e caktuara të komunitetit lokal**).


Gjithashtu aktiviteti i komunës në këtë pjesë ka qenë zero, duke mos lëvizur në drejtimin e zbatimit të PZHK-së për implementimin e “gjelbrimit” në këtë zonë.

Po ashtu investimi që pretendohet të bëhet pas ndryshimit të destinimit të kësaj parcele do të jetë i madh dhe me ndikim në ekonominë e komunës, propozohet ky vendim.

Pala, ka bërë një deklaratë, ku thekson se nëse komuna ka interes të realizojë destinimin e PZHK-së për ngastrën e tij kadastrale, ai nuk do të jetë pengesë.

Drejtori i DUKMM, Ukshin Çallaku



 REPUBLIKA E KOSOVËS	0101 - Formulari për kërkesë apo ankesë	 KAÇANIKU
	Drejtorati - Njësia DUKMM	Data 14.07.2018 (dita / muaji / viti)

1 Informatat personale të parashtruesit të kërkesës.		Mos shkruani në Pranuar nga: Numri i protokollit: 3504-30930 Vendimi: po Nga: Data:
Emri dhe mbiemri MEVLUDE DUSHKAJA	ID-Numri i dokumentit identifikues	
Data e lindjes 25.10.1968 (dita / muaji / viti)	Adresa e vendbanimit Rr. "QAMIL ILAZI" Nr. 250 (numri i shtëpisë/banorës, rruga, fshat/qyteti, kodi postar)	
Numri i tel. fiks	Numri i tel. mobil 045-405-161	
E-mail adresa		

2 Selektlo llojin:	
Kërkesë ☒	Ankesë ☐

3 Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:
Kërkoj nga Drejtoria e Urbanizmit që të lejohet ndërtimi i destinimit të parces 516/1 zona katastrale Kaçanik nga destinimi zonë rekreative sportive në Afari zëm industrial. Bashk me këtë kërkesë e dorëzoj edhe kontratën LRP. nr. 2186/2018 Nr. Ref. 576/2018 në të cilën shihet edhe qëllimi i bërjes së kësaj kërkesë.

4 Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi
Unë <u>Merlude Dushkaja</u> (Emri i plotë i aplikuesit)
Dëshmitë e bashkuara janë të vërteta.  (Nënshkrimi)

Ju lutemi të kërkontë nga zyrtarja fletëdëshnatë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitur.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR / MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA / MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917048-00516-1

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	941-30925/2018
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	14.09.2018 - 14:33
Komuna / Opština / Municipality:	Kaçanik / Kačanik / Kačanik
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	KAČANIK / KAČANIK / KAČANIK
Zyra Kadastrale Komunalne / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	Kaçanik / Kačanik / Kačanik

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-70917048-00516-1	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shqiptare / Drushtvena Imovina / Socially owned Land	Rural	9401	70-2009	13.02.2016	13.02.2016

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivaliste - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
TE MUJLINI/TE MUJLINI/TE MUJLINI		TE MUJLINI	13.02.2016	13.02.2016

A.2 LLOJTI SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Toke Tjetër/Ostalo Zemljište/OtherLand	Shpella/Pecina/alcove		9401

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licen broj ID. No.	Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Poseëim individual / Individualna Drzavina / single possessor	DUSHKAJA MEVLUDE (SELIM)	1012722792	KAÇANIK / KAÇANIK / KAÇANIK /		RESHAT SHEHU	1/1	RIK. AKTV-KOMISONIT NR.09-141-2015 DT. 30.12.2015, PROCESVERBAL NR. 09-141-2015 DT. 26.11.2015	15.02.2016

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAÇANIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kaçanik

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m2
P-70917048-00516-1	Parcelë / Parcela / Parcel	9401,0
06-944-30926/2018		



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1644

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 14.09.2018

Koha/ Vreme/ Time: 02:36:36

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved:

Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:





REPUBLIKA E KOSOVËS

NOTER

Mr.sc.Hebib V.Livoreka
Kaçanik

LRP.nr.5374/2018

Më 21.09.2018, (Njëzet e një shtator dymijë e tetëmbëdhjetë), para meje, noterit të mëposhtë nënshkruar Mr.sc.Hebib V.Livoreka, me seli në Kaçanik, Rr. "Qamil Ilazi"pn, me kërkesën që në bazë të deklarimit të vullnetit të tyre të lire, të përpiloj **aktin noterial Deklaratën nën Betim** u paraqitë:-----

1. Mevlude Dushkaja e lindur më 25.10.1968 në Kaçanik, me vendbanim në Kaçanik., shtetas i R.Kosovës, me nr. personal:1012722792, identitetin e të cilit e vërtetova në bazë të leternjoftimit të lëshuar nga MPB.R.Kosoves me validitet deri me date:28.09.2026, në cilësinë e deklaratedhënësit (në tekstin e mëtejme deklaratedhënësi)-----

E pranishmja deklaronë se do ta deklarojë të vërtetën. Pales iu është tërhequr vërejtja nga noteri i poshtë nënshkruar lidhur me pasojat dhe domethënien e deklarates së saj, si dhe sanksioneve penale të cilave mund t'i nënshtrohet në rast se deklarata e saj është në kundërshtim me të vërtetën, neni 307 par.1 dhe 2 të KPK (Kodit Penal të Kosovës)-----

Pasi që u binda me dëshirën dhe vullnetin e shprehur të palës si dhe u binda se ka aftësinë e plotë të veprimt të ndërmarrjes së kësaj pune juridike, pala prezente më mandatoi të përpilojë: -----

DEKLARATË NËN BETIM

Unë **Mevlude Dushkaja**, me përgjegjësi të plotë deklarojë se: jam pronare e parces me nr: 00516-1. ZK-KAÇANIK, Pjesa e pronës 1/1, sipërfaqja 9401 metra katrorë, ne baze te Certifikates se Prones me nr : 941-30925/2015 e dates 14.09.2018 e lëshuar nga Zyra Kadastrale Kaçanik, andaj deklarojë se ngastra kadastrale ku une jam pronare, me planin zhvillimor komunal ka destinim " Gjelbërim", kurse une kam bere kerkese qe ky destinim te ndryshohet nga Gjelberim ne Afarizem Industrial, po ashtu deklaroje se ne rast se Komuna ka interes qe kjo parcele te rikthehet ne aktivitetin gjelberim une nuk do te bej pengese.

Betohem në nderin tim që jam shprehur me sinqeritet dhe besnikërisht në përgjegjësi ndaj të gjitha pyetjeve që na janë bërë nga ana e noterit, për sa i përket kësaj qështje dhe që nuk kam fshehur asnjë fakt për të cilin jam në dijeni lidhur me këtë qështje.-----

Shpenzimet për punën dhe zyrën e noterit u llogaritën sipas tarifës noteriale, udhëzimi administrative nr.3/2012, neni 21 par.8, në lartësi prej 10.00 (dhjetë) € + TVSH 1.80 gjithsej 11,80 euro-----


Ky akt noterial është lëshuar en brevet, pasi që noteri i'a ka lexuar personit të paraqitur-të lartëcituar, u miratua nga këta të fundit dhe u nënshkrua së bashku me noterin, në seancën e mbajtur në zyrën e noterit në Kaçanik, me 21.09.2018, (Njëzet e një shtator dymijë e tetëmbëdhjetë)-----

Akti përbëhet në një fletë dhe një faqe-----

Deklaratedhënësja:-----

Mevlude Dushkaja 

Noter-Mr.Sc.Hebib V.Livoreka



V. DISPOZITAT PËR ZBATIM

Plani Zhvillimor Komunal së Kaçanikut është një dokument bazë që parasheh zhvillimin e dëshiruar hapësinor për të ardhmen. Bazuar në gjendjen ekzistuese dhe sfidat kryesor që janë identifikuar, është përcaktuar vizioni për të ardhmen si dhe qëllimet që duhet të arrihen. Gjithashtu është propozuar korniza e zhvillimit komunal sipas të cilës do të realizohet një zhvillim policentrik dhe i qëndrueshëm. Strategjia e zhvillimit komunal parasheh fushat konkrete dhe mënyrën se si do të arrihet zhvillimi dhe mbrojtja për tërë territorin e komunës. Plani është shumë real dhe i zbatueshëm. Zbatimi konkret i këtij plani është prezantuar në këtë pjesë, ku përshkruhen dispozitat për zbatim, përmes të cilave përshkruhet mënyra më konkrete e zbatimit praktik të këtij plani. Pra jepen udhëzimet dhe sugjerimet për realizimin e strategjisë së propozuar, me tërë përmbajtjen e sajë, duke përfshirë afatet kohore, implikimet financiare dhe hapësirën përkatëse.

V.1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Në këtë pjesë jepen informata për parimet e përgjithshme të implementimit të planit, ku përfshihen afatet kohore dhe periudhat e revidimit të planit, përgjegjësit dhe kompetencat për revidimin e tij si dhe rëndësinë e këtij dokumenti në nivelin komunal.

- Plani Zhvillimor Komunal është hartuar për periudhën kohore 2009 - 2020 dhe jep mundësin e vazhdimësisë së planifikimit.
- Rishikimi i Planit bëhet çdo pesë vite, por rishikimi dhe ndryshimet eventuale mund të bëhen edhe në periudha tjera kohore, varësisht nga vendimet politike apo kërkesat e caktuara të komunitetit lokal.
- Përgjegjës për revidimin e Planit është Qeveria komunale së Kaçanikut, konkretisht Drejtoria për Urbanizëm.
- Plani është hartuar në pajtim me të gjitha konventat dhe parimet ndërkombëtare të fushës së Planifikimit Hapësinor dhe zhvillimit të qëndrueshëm.
- Plani gjithashtu është në përputhje të plotë me ligjin për Planifikim Hapësinor 2003/14 dhe Ligji L-03/L-106 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor të Republikës së Kosovës.
- Plani merr parasysh të gjitha projektet e përcaktuara për tu realizuar si nga niveli qendror ashtu edhe nga niveli komunal.
- Dispozitat për zbatim përcaktojnë mënyrën e rregullimit, zhvillimit dhe mbrojtjes së hapësirave sipas destinimit të përcaktuar.
- Plani përfshinë projekt-elaboratin me titull "Plani Zhvillimor Komunal i Kaçanikut 2009 - 2020" që është hartuar në vitin 2009 nga Komuna e Kaçanikut përmes kompanisë DataGIS Consulting, dhe përbëhet nga: pjesa tekstuale dhe ajo grafike (harta, grafikone, tabela dhe foto të ndryshme).
- Ky plan është dokumenti kryesor për zhvillimin e ardhëm hapësinor dhe planet tjera siç janë ai urban dhe planet rregulluese i nënshtrohen këtij plani.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

01Nr. 104/02-31498/18
Kaçanik, 27.09. 2018

Në bazë të nenit 12.1 dhe 14 lidhur me nenin 82.2 të Ligjit 03/L-040 –Për Vetëqeverisje Lokale(Gazeta Zyrtare Nr. 28/ 04 Qershor 2008), të nenit 53 të Ligjit Nr. 05/L- 031- për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 19/ 16 Qershor 2016), duke vepruar sipas Kërkesës së MAPL Nr.020-878/4 të datës 27.08.2018, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë: 27 Shtator 2018, mori këtë:

V E N D I M

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMI 01Nr. 350/02-21705/18 I DATËS 17 KORRIK 2018 - PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RISHQYRTIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL DHE HARMONIZIMIN E TIJ ME LIGJIN PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR NR. 04/L-174.

1. Me këtë Vendim, **SHFUQIZOHET** Vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 350/02-15509/18 i datës 17 Korrik 2018- Për fillimin e procedurës për rishqyrtimin e Planit Zhvillimor Komunal Nr. 06-9849/2010 të datës 28 Dhjetor 2010 dhe harmonizimin e tij me Ligjin e Planifikimit hapësinor Nr. 04/L-174.
2. Vendimi për shfuqizimin e Vendimit të përcaktuar si në pikën 1 të këtij Vendimi bëhet pas Kërkesës së MAPL 020-878/4 të datës 27 Gusht 2018, respektivisht konfirmimit të ligjshmërisë nga ministria e linjës- Ministria për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për shkak së i njëjti bien ndeshë me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor.
3. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.


Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit(përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante) dhe Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01Nr 104/62-31498/18

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 14, paragrafit 14.1 të Ligjit Nr.03/L-040, për vetëqeverisje lokale, ligjit për planifikim hapësinor 04/L-174, Statutit të Komunës së Kaçanikut dhe shkresës përcjellëse të MAPL-së Nr. 020-878/4, drejtori i DUKMM-së bën këtë:

PROPOZIM VENDIM PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT KOMUNAL 01.Nr.350/02-21705/18

I

Me këtë propozim vendim MIRATOHET kërkesa e DUKMM-së për shfuqizimin e vendimit të kuvendit komunal 01.Nr.350/02-21705/18

II

Sipas pikës I të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi për rishqyrtimin e Planit Zhvillimor Komunal për Komunën e Kaçanikut.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen : Kryetari I Komunës, Drejtoria Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Arsyetim

Pasiqë komuna e Kaçanikut ka pranuar shkresën përcjellëse nga MAPL e cila pas marrjes së mendimit nga ministria e linjës MMPH, kanë vlerësuar se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.



Kryetari z. Besim Ilazi



Drejtori i DUKMM

Ukshin Çallaku



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 350/02- 21705/18
Kaçanik: 17. 07.2018 2018

Në bazë të nenit 12.2(d) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/ 04 Qershor 2008), të nenit 10 të Ligjit Nr. Nr. 04/L-174 Ligjin për Planifikim Hapësinor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/ 23 Gusht 2013). Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më 17 Korrik 2018, mori këtë:


V E N D I M

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RISHQYRTIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL NR. 06-9849/2010 TË DATËS 28.12.2010 DHË HARMONIZIMIN E TIJ ME LIGJIN E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR NR. 04/L-174.

1. Me këtë Vendim, miratohet Propozim Vendimi i DUKMM për Rishqyrtimin e Planit Zhvillimor Komunal.
2. Plan i Zhvillimor Komunal duhet të adaptohet me nevojat e Komunës së Kaçanikut, dhe të harmonizohet me Ligjin për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174.
3. Me këtë Vendim, autorizohet Kryetari i Komunës së Kaçanikut t'i formoj grupet punuese për realizimin e këtij plani.
4. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e dërgimit të aktit në MAPL respektivisht 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Arkiva.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, Datë: 24.08.2018
Nr.020-878/3

Për: Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut
Kemajl Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut

Lënda: Shkresë përcjellëse

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar vendimin nr.350/02-21705/18 për fillimin e procedurave për rishqyrtimin e Planit Zhvillimor Komunal nr.06-9849/2010 dt. 28.10.2010 dhe harmonizimin e tij me Ligjin për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut dhe nënshkruar nga Kryesuesi i KK të Kaçanikut, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Duke u bazuar në nenin 7 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2016 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), me datë 26.07.2018, ka përcjellë aktin e lartshënuar për vlerësim të ligjshmërisë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Bashkangjitur gjeni Raportin nga MMPH lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë.

Me respekt,

Rozafa Ukimeraj
Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së

Kopje: Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave
Arkivit të MAPL-së



04 4283-40
- 03 - 22 08 18
Prishtine, 18

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Për :	Ivan Todosijeviq, Ministër në MAPL Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL	
Cc:	Njësia për Administrimin e dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e dokumenteve në Komunë Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	
Përmes:	Fatmir Matoshi, u.d. Minister i MMPH-së Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së	
Nga:	Sabrije Rama , u.d.Drejtor i Departamentit Ligjor. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	Datë: 13.08.2018
Lënda:	Kërkesë për Rishqyrtimin e Ligjshmërisë	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Ministër,
E nderuar Sekretare,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut 01Nr.350/02-21705/18 dt.17.07.2018 për fillimin e procedurave për rishqyrtimin e Planit Zhvillimor Komunal Nr.06-9849/2010 dt.28.10.2010 dhe harmonizimin e tij me Ligjin për Planifikimin Hapësinor Nr.04/L-174.

I miratuar me datë: 17.07.2018

I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë: 23.07.2018

I dërguar për shqyrtim në MMPH, me datë: 26.07.2018

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Mos pajtueshmëri të aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendimi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut 01 Nr.350/02-21705/18 të datës 17.07.2018, për fillimin e procedurave për rishqyrtimin e Planit Zhvillimor Komunal Nr.06-9849/2010 të datës 28.10.2010 dhe harmonizimin e tij me Ligjin për Planifikimin Hapësinor Nr.04/L-174. Vendimi	- Vendimi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut 01Nr.350/02-21705/18 të datës 17.07.2018, për fillimin e procedurave për rishqyrtimin e Planit Zhvillimor Komunal Nr.06-9849/2010 të datës 28.10.2010 dhe harmonizimin e tij me Ligjin për Planifikimin Hapësinor Nr.04/L-174, është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor. - Vendimi për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal duhet të hartohet në bazë të Nenit 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor. - Pjesë e Vendimit për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal duhet të jetë edhe Programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit. -Neni 10 paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 i Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor nuk njeh termin "<i>rishqyrtim të PZHK</i>" por vetëm "<i>hartim të PZHK – së</i>".

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i propozon MAPL-së që të kërkojë nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.